

Analiza Vjetore e KLSH-së për vitin 2021

Në datën 15 shkurt 2022, u zhvillua në mjediset e KLSH-së, analiza vjetore e punës së institucionit për vitin 2021 pas përmbylljes me sukses të analizave të veçanta të departamenteve të auditimit, në bashkëpunim edhe me disa prej Universiteteve në vend si ai Shkodrës, Elbasanit, Vlorës, Universiteti Bujqësor i Kamzës, etj.



Në fjalën e tij hyrëse, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, falenderoi të pranishmit për punën e zhvilluar gjatë vitit 2021 pavarësisht vështirësive dhe për angazhimin në kryerjen e proceseve audituese me përgjegjshmëri, seriozitet dhe profesionalizëm për të zhvilluar edhe më shumë kapacitetet audituese edhe njerëzore në institucion, por edhe për t'i ofruar publikut dhe Kuvendit auditime sa më të vlefshme, me impakt shoqëror dhe sa më transparente, sa i takon gjetjeve dhe luftës ndaj fenomenit të korrupsionit.

Në vijim, Drejtoresha e Përgjithshme e KLSH-së, znj. Marjola Llanaj, përmbledhi të gjithë ekspozën e aktivitetit auditues në KLSH për vitin 2021. Në fjalën e saj znj. Llanaj theksoi faktin se edhe pse viti 2021 ishte një vit që ndikoi si në jetën ekonomike dhe atë sociale të çdo qytetari në Republikën e Shqipërisë, ashtu si dhe në pjesën tjetër të botës, nga pandemia e COVID-19, KLSH arriti që të përmbushte detyrimin kushtetues që, çdo auditim të përbënte një vlerë të shtuar

për çdo institucion të audituar, si dhe për të rritur besimin tek taksapaguesit shqiptarë për rolin e KLSH-së si mbikëqyrës i interesave të tyre.

Vizioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si agjent i Parlamentit dhe shërbëtar i qytetarit” është në të njëjtën linjë me moton e institucioneve ndërkombëtare të auditimit ku “**Auditimi Kombëtar është në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare dhe jo të qeverive**”.

Puna audituese e KLSH-së ka mbuluar institucionet e qeverisjes së përgjithshme, njësitë e pushtetit vendor, administratën tatimore dhe doganore, shoqëritë me kapital shtetëror, etj në një total prej **205 subjektsh** me **158 auditime të evaduar** me synim dhënien e opinionit për zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e parasë publike, sipas kësaj tipologjie:

- 41 auditime përputhshmërie dhe rregullshmërie;
- 56 auditime përputhshmërie;
- 21 auditime financiare;
- 18 auditime performance;
- 17 auditime tematike; dhe
- 5 auditime të IT.

Në realizimin e këtyre auditimeve janë angazhuar rreth **170** auditues të profesioneve, përvojave dhe formimeve bazë të ndryshme, të kombinuar në numër sipas problematikave të subjekteve, nivelit të transaksioneve, madhësisë dhe risqeve që mbartin disa lloje aktivitësh, ekspertizës për historikun e shkeljeve të mëparshme të ligjshmërisë për këto zyra e institucione publike, etj.

Për vitin 2021 rezulton se indikator i dobishmërisë është 56.3, që do të thotë se për çdo një lek të shpenzuar për KLSH-në nga Buxheti i Shtetit janë zbuluar nga auditimet e kryera **56.3 lekë**.

Karakteristikë që duhet theksuar është, se me gjithë veçoritë që kanë karakterizuar vitin 2021, KLSH ka arritur që **të ruajë dhe të jetë mbi trendin mesatar të numrit vjetor të auditimeve të kryera në periudhën 2011-2021** prej mesatarisht 155 të tilla, si dhe është rritur përqindja e auditimeve financiare, e numrit të auditimeve të performancës dhe e numrit të auditimeve IT.

Bazuar në gjetjet e konstatuara në procesin auditues dhe me synim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve dhe pronës publike, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, KLSH ka rekomanduar 90 masa për ndryshime ose përmirësime ligjore, 3074 rekomandime me karakter organizativ dhe 1088 rekomandime disiplinore dhe administrative.

Në vitin 2021, KLSH ka kryer ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve në 62 subjekte të audituara gjatë vitit 2020, nga ku ka rezultuar se janë dhënë gjithsej 1376 masa për përmirësime ligjore, masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore, prej të cilave janë pranuar 1292 ose 93% e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar 84 masa ose 6% e masave të rekomanduara. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga 1292 masa të pranuar, janë zbatuar (plotësisht dhe pjesërisht) 720 masa ose 55%, janë në proces zbatimi 316 ose 24.4% dhe 256 masa nuk janë zbatuar ose 19.8%.

Gjithashtu, duke pasur në qendër të vëmendjes luftën ndaj korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes si dhe të mashtrimit financiar në përdorimin e fondeve dhe të pasurisë publike, me qëllim rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publikë, si dhe të efekteve parandaluese nëpërmjet ndëshkimit të personave, të cilët janë vlerësuar se gjatë veprimtarisë tyre kanë pasur elementë të veprës penale, për vitin 2021 KLSH ka përcjellë **14 Kallëzime Penale për 62 persona**.

Në përfundim të fjalës së saj, znj. Llanaj theksoi se gjatë vitit 2021, KLSH kishte përbushur plotësisht **përgjegjësitë kushtetuese, detyrimin ligjor, si dhe misionin e vet auditues** duke dëshmuar për një aktivitet që reflekton integritet dhe paanshmëri, në pajtueshmëri me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit.

Në fjalën e saj, Sekretarja e Përgjithshme e KLSH-së, znj. Valbona Gaxha vijoi me një përmbledhje të aktiviteteve dhe detyrimeve të tjera institucionale të përbushura gjatë vitit 2021. Në miratim të planit të veprimit KLSH –së si dhe në përbushje të detyrimeve vjetore kushtetuese, institucioni ka paraqitur në Kuvend:

- Raportin vjetor të Performancës për vitin 2020 dhe;
- Raportin e Zbatimit të Buxhetit;

Duke e konsideruar Kuvendin e Shqipërisë si partnerin kryesor për rritjen e impaktit të punës audituese, KLSH ka informuar atë nëpërmjet përcjelljes së raporteve të cilat japin informacion të detajuar mbi përdorimin e parasë publike. Gjatë vitit 2021, në Kuvend janë përcjellë:

- 57 raporte të auditimit të evaduara gjatë vitit 2021;
- 2 buletine statistikore;
- 3 raporte të zbatimit të rekomandimeve, të cilat japin informacion të detajuar për zbatimin e tyre nga institucionet publike.

Informacion i detajuar është përcjellë edhe në platformën elektronike të Kuvendit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për 12 institucione qendrore dhe institucione të varësisë të audituara gjatë vitit 2020.

Në zbatim të nenit 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31 të Ligjit 154/2014 “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, KLSH në mars të vitit 2021 i ka paraqitur Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2020. Kuvendi i Shqipërisë duke vlerësuar KLSH-në si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm, rolin e tij të qenësishëm për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe duke e mbështetur dhe nxitur atë për të punuar dhe kontribuar për mirëqeverisjen nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit, ka miratuar në datën 24.06.2021 “*Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2020*”.

Me synim evidentimin e progresit të KLSH-së për implementimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, KLSH ka miratuar Planin e Veprimit nr. 755/1, datë 01.09.2021, në të cilin janë përcaktuar qartazi 20 masa që do të ndërmerren, strukturat përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet dhe treguesit e rezultateve. Nga monitorimi i zbatimit të planit të veprimit rezulton se:

- KLSH ka rritur ndjeshëm **numrin e auditimeve financiare dhe ka përmirësuar cilësinë e tyre me opinione profesionale nëpërmjet kryerjes së 21 auditimeve të financiare** të cilat zënë 13.2% të totalit dhe 41 auditime financiare dhe të përputhshmërisë, në të cilat janë dhënë opinione si për pasqyrat financiare ashtu dhe për përputhshmërinë e aktivitetit me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat përbëjnë 26 % të totalit të auditimeve të kryera në vitin 2021;

- KLSH ka **rritur numrin e auditimeve të performancës**, të cilat përbëjnë 13.3 % të auditimeve të planifikuara nga KLSH. Për shkak të rëndësisë që ka për Kuvendin dhe opinionin publik menaxhimi i fondeve për përballimin e pasojave të tërmetit të nëntorit 2019 dhe masat e marra nga institucionet shtetërore për minimizimin e pasojave të pandemisë Covid-19, KLSH ka kryer auditimet me temë: *“Efektiviteti i programeve për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore 2019”* dhe *“Efektiviteti i menaxhimit të situatës pandemike Covid-19”*;
- KLSH për vitin 2022 do të realizojë një temë auditimi që do të fokusohet në auditimin e implementimit të **Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së**;
- KLSH ka implementuar rekomandimin për *aplikimin e praktikave më të mira të auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t, përditësimin me informacion të subjekteve të audituara dhe projekteve të rëndësishme të qeverisjes elektronike, duke mbajtur në konsideratë raportin kosto/përfitim dhe sigurinë e sistemeve* nëpërmjet hartimit të një databaze të subjekteve sipas përcaktimit ligjor për Auditimin IT e cila përmban 267 subjekte. Nga vlerësimi paraprak i riskut rezulton se 36 subjekte kanë risk të lartë dhe nga kjo databazë KLSH ka audituar 15 subjekte;
- **KLSH për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë audituese dhe për të zhvilluar atë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit**, aktualisht ka ngritur grupin e punës, i cili po punon për përmirësimin e Rregullores së Procedurave të Auditimit. Sigurimi i cilësisë gjatë procesit auditues dhe forcimi i tij në çdo hallkë është kryer nëpërmjet kontrollit të cilësisë së auditimit “në të nxehtë” për çdo auditim të evaduar vitin 2021. Raporti i kontrollit të cilësisë “në të ftohtë” i pothuajse 30 % të dosjeve të auditimit të evaduara në vitin 2021 do të finalizohet në fund të muajit shkurt.

Me qëllim rritjen e transparencës duke mundësuar zhvillimin e një komunikimi interaktiv me qytetarin nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ku të publikohen vendimet dhe raportet e plota të auditimeve, sipas afateve të përcaktuara në ligj dhe të rekomanduara nga KE-ja, KLSH e ka realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të internetit:

- Raportin e Performancës së KLSH-së për vitin 2020;
- Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020;
- Publikimin e 100 raporteve të auditimeve të evaduara gjatë vitit 2021;
- Publikimin e 66 njoftimeve për shtyp nëpërmjet të cilave janë informuar palët e interesit për gjetjet dhe rekomandimet e lëna për subjektet e audituara.

KLSH në përmbushje të objektivave të Strategjisë së Zhvillimit 2018-2022 vlerëson se, bashkëpunimi me **institucionet ndërkombëtare** i shërben ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit. Përmendim si vijon:

- Për të forcuar kapacitetet profesionale të KLSH-së në kryerjen e auditimeve me fokus prokurimin publik dhe rritjen e cilësisë së tyre, prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka zhvilluar në partneritet me Autoritetin Kombëtar Italian Kundër Korrupsionit (ANAC) webinarë trajnuese për stafin e KLSH-së;

- Partneriteti publik-privat është objekt i marrëveshjes së nënshkruar nga KLSH me Ambasadën Zvicerane për financimin nga Sekretariati i Çështjeve Ekonomike të Zvicrës (SECO) të projektit *“Forcimi i mbikëqyrjes së kontratave të koncesionit dhe partneritetit publik privat në Shqipëri”*, i cili do të përmbillet me hartimin e udhëzuesit specifik për auditimin e kontratave koncesionare dhe PPP, si dhe do të asistohen audituesit, në auditime specifike që fokusohen në këto çështje;
- KLSH pjesë e iniciativës së IDI-t *“Strategjia, Matja e Performancës dhe Raportimi (SPMR)”*, ku përmes trajnimeve dhe asistencës me ekspertë do të kryhet edhe vetëvlerësimi i performancës së institucionit duke përdorur Metodologjinë e Kornizës së Matjes së Performancës së INTOSAI-t, hartimi i Strategjisë së re të Zhvillimit të institucionit dhe monitorimi i saj;
- KLSH duke e konsideruar SIGMA-n si një nga partnerët më të vyer ka dakordësuar asistencën e saj për hartimin e Strategjisë së Komunikimit 2022-2025 dhe hartimin e Manualit të Auditimit të Buxhetit;
- KLSH ka dakordësuar bashkëpunimin me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Norvegjisë, e cila do të trajnojë dhe asistojë audituesit e KLSH-së në fushën e auditimeve IT dhe atyre të mjedisit duke u përmblyllur me auditime pilot në fushat respektive.

Në cilësinë e anëtarit të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, KLSH ka vijuar intensifikimin dhe thellimin e bashkëpunimit me SAI-t homologe si partnerë strategjikë jo vetëm brenda anëtarësimit në këto dy organizma, por edhe në kuadrin dy palësh. Përmendim bashkëpunimet si vijon:

- Në memorandumun e nënshkruar ndërmjet INTOSAI-t dhe Zyrës së OKB-së për Krimin dhe Drogën (UNDOC) palët janë angazhuar ndër të tjera edhe për hartimin e udhëzuesit *“Ngritja dhe intensifikimi i marrëdhënieve të punës midis Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Institucioneve Anti-Korrupsion në parandalimin dhe luftën kundër Korrupsionit”* ku në grupin e ekspertëve është përfshirë edhe një përfaqësues i KLSH-së. Në draftin e udhëzuesit që pritet të miratohet brenda vitit 2022 është evidentuar roli i KLSH-së për *“promovimin e qeverisjes së mirë, zbatimin e standardeve etike dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e mashtrimit dhe korrupsionit”*, duke vënë theksin tek veprimet konkrete për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme, Prokurorinë e Përgjithshme dhe disa organizata të shoqërisë civile;
- KLSH në cilësinë e anëtarit të disa prej grupeve të punës të EUROSAI-t, ka marrë pjesë aktive në aktivitetet e zhvilluara nga këto grupe, të cilat veprojnë në fushën e auditimit të mjedisit, auditimit IT, auditimit të fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat dhe auditimit të bashkive;
- KLSH ishte pjesë e institucioneve supreme të auditimit të cilat kryen auditimin paralel të performancës me temë: *“Menaxhimi i ndërhyrjeve në rast të ndotjes së papritur në detin Adriatik”*;
- KLSH është pjesë e institucioneve supreme të auditimit të cilat kanë filluar kryerjen e auditimit të performancës me temë *“Mbetjet plastike”* dhe *“Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e bashkive për të siguruar shërbime cilësore për qytetarët gjatë pandemisë”*. Me asistencën e SAI-t të Suedisë KLSH është drejt hartimit të raportit përfundimtar të auditimit të performancës me temë *“Të drejtat e pasagjerëve në transportin ajror”*;

Shkëmbimi i eksperiencave për tema me interes të përbashkët me SAI-et homologe gjatë vitit 2021 ka vijuar në takimet, seminarët, workshop-et, tryeza të rrumbullakëta dhe trajnime të zhvilluara online të cilat kanë patur në fokus:

- Pavarësinë e institucioneve supreme të auditimit;
- Kontributin e SAI-eve në luftën kundër korrupsionit;
- Auditimet e kryera nga SAI-et për parandalimin e pasojave të pandemisë Covid-19;
- Shkëmbimin e eksperiencave për kryerjen e auditimeve të performancës dhe Teknologjisë së Informacionit;
- Auditimin e procedurave të prokurimit publik;
- Ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të SAI-eve.

Gjatë vitit 2021, përfaqësues të KLSH-së kanë marrë pjesë në 44 takime, seminare, workshop-e dhe trajnime me një total prej 437 ditë/njerëz.

KLSH ka konsideruar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit nëpërmjet trajnimit si prioritetin kryesor. Procesi i trajnimit të vazhdueshëm funksionon në mënyrë efektive dhe gjatë vitit 2021 trupa audituese e KLSH-së, ka realizuar 27 ditë trajnimi/auditues, nga 25 ditë trajnimi/auditues të planifikuara dhe nga audituesit e rinj janë kryer 30.5 ditë mesatare trajnimi. Ky tregues është realizuar në masën 109 % kundrejt objektivit dhe audituesit janë trajnuar për bazën ligjore të KLSH-së, standardet dhe metodologjinë e auditimit, si dhe për çështje specifike të cilat lidhen me kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së auditimit dhe auditimin e procedurave të prokurimit publik dhe marrëveshjet koncesionare.

Gjatë vitit 2021, veprimtaria e KLSH-së ka qenë subjekt i vlerësimit të disa institucioneve ndërkombëtare. **Progres-Raporti i vitit 2021** për Shqipërinë në vlerësimet për kapitullin 32 *“Kontrolli financiar”* nënvizon se: *“Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), kuadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Vitet e fundit, KLSH ka marrë masa për zhvillimin profesional të stafit auditues. KLSH ka vijuar të rrisë ndërgjegjësimin e botës akademike dhe shoqërisë civile mbi rëndësinë e auditimit të jashtëm”*.

Gjatë vitit 2021, **SIGMA kreu procesin e vlerësimit për principet e administratës publike në Shqipëri**. Pjesë e këtij vlerësimi ishte edhe veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit. KLSH është vlerësuar pozitivisht për :

- Mënyrën e raportimit dhe shqyrtimit transparent të buxhetit;
- Sigurimin e pavarësisë, mandatit dhe organizimit të institucionit suprem të auditimit, nga kuadri kushtetues dhe ligjor dhe respektimi në praktikë;
- Zbatimin nga KLSH të standardeve në mënyrë neutrale dhe objektive për të siguruar auditime me cilësi të lartë, të cilat ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik.

Gjatë vitit 2021, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore në një linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore dhe është miratuar

struktura organike me një total prej 218 punonjësish, nga të cilët numri i stafit auditues ishte 148 punonjës dhe përbën 78.7% të numrit total të punonjësve.

Më tej, z. Bexhet Zeqiri, Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, vijoi me një përmbledhje të aktivitetit të kësaj drejtorie duke e vënë theksin në problematikat e hasura me auditimet “në të nxehtë” dhe “në të ftohtë”. Gjatë trajtimit të këtyre problematikave, u konsiderua me rëndësi të theksohej fakti se në krahasim me vitet e kaluara, ka pasur përmirësime të ndjeshme në disa tregues përgjatë vitit 2021.

Në përmbyllje të kësaj analize, u dakordësua për një vëmendje maksimale në zhvillimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit, jo vetëm brenda institucionit por edhe jashtë tij, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe nivelit profesional për të pasqyruar sa më saktë punën e KLSH-së duke dhënë kontribut të veçantë në zbatimin e ligjit.